



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. ____prot.

Prrenjas,

më

____.____.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik: **“Curri” sh.p.k** me NIPT J67902718S me adrese Tirane, Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga Kajo Karafili, Pallati Bimbashi 8/2, Shkalla 2, Kati II, Ap.2B, me administrator Z.Faik Curri .

Procedura e prokurimit: Procedure e Hapur-Pune-Elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-42680-11-08-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstrukcion rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini nr. 46 datë 18.11.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☒ oferta ekonomike më e favorshme

Fondi limit: 178,979,703 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tre) lekë pa TVSH.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik “Eurogjici-Security” shpk** me NIPT K31929010K, me adrese: Tirane Rruga Adem Jashari, Lagjia nr.8, Ndertesa 4, Hyrja 10, Ap.3, Njesia Bashkiake nr.5 me administrator Z.Lavdrim Gjici **nuk ka paraqitur formular oferte ekonomike.**
2. **BOE: “Alko-Impex General Construcion” shpk** me NIPT K91326028I, me adrese: Tirane, Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, kati i 8, prane stacionit te trenit me perfaqesues ligjor Z.Arbër Abazi dhe **“Junik” sh.p.k** me NIPT J68007522L me adrese Lezhe me administrator Z.Ded Malutaj me oferte ekonomike **157,506,982.3 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy pikë tre) leke pa TVSH.**
3. Operatori ekonomik **“BE-IS” sh.p.k** me NIPT K71412003A me adrese Kukes, Lagjia nr.1, pallati Metalurgu, hyrja nr.1 me administrator Z.Kastriot Ibrahimaj me oferte ekonomike **178,957,145.21 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e dyzet e pesë pike njëzet e një) leke pa TVSH.**
4. Operatori ekonomik **“Curri” sh.p.k** me NIPT J67902718S me adrese Tirane, Njësia Bashkiake

Nr.10, Rruga Kajo Karafili, Pallati Bimbashi 8/2, Shkalla 2, Kati II, Ap.2B, me administrator Z.Faik Curri me oferte ekonomike **178,332,403.62 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e tre pikë gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.**

5. **BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k** me NIPT K61625001I me adrese Tirane, Njesia Administrative nr.7, Rruga Frederik Shiroka, Nderresa 6, Hyrja 10, Apartamenti 6, me administrator Z.Alfred Ibrahim, **“Arkonstudio” sh.p.k** me NIPT L42019004I me adrese Tirane, Rruga Mihal Duri, objekti nr.33, me administrator Z.Nasjel Çiço dhe **“Viante Konstruksion” sh.p.k** me NIPT K47103804L me adrese Elbasan, Gramsh, Gramsh Sporti, me administrator Z.Gjergji Bezati me oferte ekonomike **145,021,471 (njëqind e dyzet e pese milion e njezet e nje mije e katerqind e shtatedhjetë e nje) leke pa TVSH.**
6. Operatori ekonomik **“Ergi” sh.p.k** me NIPT K02727229P me adrese Elbasan, Autostrada Elbasan-Metalurgji km.3, numri i pasurise 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, lagjia 28 Nentori, Rajoni nr.3, Elbasan, me administrator Z.Ergi Balla me oferte ekonomike **178,935,324 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH .**
7. **BOE: “Sireta 2F” sh.p.k**, me Nipt K51501008J me adresë: Tirane, Paskuqan, Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan, me administrator Fatime Pali, **“Vllaznia Ndertim I.S” sh.p.k** me NIPT K77524909Q me adrese Diber, Burrel, Lagjia Pjeter Budi me adm Z.Arben Çela dhe **“Ndregjoni” sh.p.k** me NIPT K31329048I me adrese Tirane, Njesia Bashkiake Nr.8, Rruga Sule Bega, Nderresa Nr. 32, Hyrja 8, me administrator Z.Xhetan Ndregjoni me oferte ekonomike **117,777,777 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mije e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) leke pa TVSH.**
8. Operatori ekonomik **“Senka” sh.p.k** me NIPT J94808405Q me adrese Fier, Lushnje, Xhevdet Nepravishta, me administratore Znj.Donika Senka **nuk ka paraqitur formular oferte ekonomike.**

Operatorë ekonomikë të skualifikuar:

1. **Operatori ekonomik “Eurogjici-Security” shpk** me NIPT **K31929010K**, administrator Z.Lavdrim Gjici .
2. **BOE: “Alko-Impex General Construcion” shpk** me NIPT K91326028I, me perfaqesues ligjor Z.Arbër Abazi dhe **“Junik” sh.p.k** me NIPT J68007522L administrator Z.Ded Malutaj .
3. **Operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k** me NIPT K71412003A me administrator Z.Kastriot Ibrahimaj .
4. **BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k** me NIPT K61625001I, **“Arkonstudio” sh.p.k** me NIPT L42019004I, me administrator Z.Nasjel Çiço dhe **“Viante Konstruksion” sh.p.k** me NIPT K47103804L, me administrator Z.Gjergji Bezati .
5. Operatori ekonomik **“Ergi” sh.p.k** me NIPT K02727229P me administrator Z.Ergi Balla .
6. **BOE: “Sireta 2F” sh.p.k**, me Nipt K51501008J me administrator Fatime Pali, **“Vllaznia Ndertim I.S” sh.p.k** me NIPT K77524909Q me adm Z.Arben Çela dhe **“Ndregjoni” sh.p.k** me NIPT K31329048I, me administrator Z.Xhetan Ndregjoni .
7. Operatori ekonomik **“Senka” sh.p.k** me NIPT J94808405Q me administratore Znj.Donika Senka .

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. S'kualifikimi i operatorit ekonomik "Eurogjici-Security" shpk me NIPT K31929010K, administrator Z.Lavdrim Gjici , për arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se

- Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet ligjore për kualifikim
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

Operatori ekonomik **"Eurogjici-Security" sh.p.k** ka paraqitur vetëm ekstraktin tregtar dhe asnjë nga dokumentat e kërkuara në dokumentat e tenderit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte dhe në mbështetje të **Enit 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" i ndryshuar, u konstatua se oferta e OE **"Eurogjici-Security" shpk** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

2. S'kualifikimi i BOE: "Alko-Impex General Construcion" shpk me NIPT K91326028I, me perfaqesues ligjor Z.Arbër Abazi dhe "Junik" sh.p.k me NIPT J68007522L administrator Z.Ded Malutaj , për arsyet e mëposhtme

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.
- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit.

1. Nuk përmbush kriterin 5.1 të kriterëve të kapacitetit teknik, pika v.

BOE ka paraqitur 5 manovratore të punësuar nga OE **"Alko-Impex General Construcion" sh.p.k** për të cilin nuk ka paraqitur Dëshmi Aftësimi Profesionale të vlefshme, e kërkuar në pikën 5.1 të kriterëve të kapacitetit teknik në pikën v.

BOE nuk ka paraqitur 8 manovratore të kërkuar në pikën 5.1.v. të kriterëve të kapacitetit teknik por vetëm 2.

2. Për përmbushjen e kriterit 5.1 të kriterëve të kapacitetit teknik, pika vi. BOE nuk ka paraqitur dokumentacionin të rregullt:

BOE ka paraqitur 2 shoferë, ndërkohë që në DT janë kërkuar 5 shoferë në total.

- **"Alko-Impex General Construcion" sh.p.k** ka paraqitur 6 automakiniste për të cilët nuk ka paraqitur patentë përkatëse sic është kërkuar në pikën vi. të kriterit 5.1 të kapacitetit teknik.

3. BOE nuk ka paraqitur inxhinier ne nivel master ose ekuivalent per Menaxhim Projektesh i kerkuar ne piken 5 germa c te kritereve te kapacitetit teknik.

4. BOE nuk ka paraqitur ing ndertimi *ne profilin strukturist* sic kerkohet ne piken 5 germa g te kritereve te kapacitetit teknik.

5. OE “Junik” shpk nuk ka paraqitur Licensen me Kodin III.2.A (1+2) dhe licensen me kodin III.2.B (1+2), te kerkuara ne piken 7 dhe 8 te kritereve te kapacitetit teknik ne DT.

6. BOE ka paraqitur kontraten e bashkepunimit nr.rep 9124 me nr.kol 2847/1 date 16.12.2019 bashkengjitur kontrates ka paraqitur edhe zerat e punimeve te ndara per 2 operatoret nga ku rezultoi se zerat 3.2.1 te preventivit nuk jane marre persiper te kryhen nga asnjeri prej operatorëve ekonomike, ne konkluzion 2 operatoret ne marreveshjen e bashkepunimit nuk i kane ndare 100% zerat e punimeve.

Nga verifikimi i kryer rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction” DSHH & “Junik” shpk është krijuar me anë të kontratës së bashkëpunimit të lidhur para noterit publik nr.9124 rep dhe nr.2847 kol datë 16.12.2019 ku referuar nenit 4 të Kontratës nuk janë përcaktuar elementët konkretë të bashkëpunimit, por vetëm është përcaktuar se shoqëria “Alko Impex” do të marrë përsipër 46 % të punimeve dhe shoqëria “Junik” 54 % të punimeve pa përcaktuar zëra konkretë të bashkëpunimit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohet se: “ 3. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. ” Sa më sipër anëtarët e BOE nuk kanë ndarë në përputhje me preventivin të gjithë punimet, pasi ka pasaktësi dhe një pjesë e punimeve sa më sipër arsyetuar nuk janë marrë fare përsipër nga asnjë prej anëtarëve të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.

7. Nuk disponon staf të kualifikuar për:

- a) 60 punonjës të certifikuar me deshmi te sigurimit teknik 60 lëshuar nga IQT ose ekuivalente në përputhje me zërat e punimeve në preventiv dhe përqindjen e bashkëpunimit.
- b) **2 Elektricist** vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- c) **2 Hidraulik** vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- d) **3 Teknik ndërtimi** vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- e) **8 Manovratorë** të mjeteve të rënda, vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme.
- f) **5 Shoferë** vërtetuar me kontratë pune dhe patentë përkatëse.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, u konstatua se oferta e **BOE: “Alko-Impex General Construcion” sh.p.k** dhe **“Junik” sh.p.k** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

3. S’kualifikimi i operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k me NIPT K71412003A me administrator Z.Kastriot Ibrahimaj, për arsyet e mëposhtme

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1. Nga listepagesat e dorezuara nga OE “BE-IS” shpk per periudhen Tetor 2018-Shtator 2019 rezulton se mesatarja e punonjesve te shoqerise eshte **118.3** punonjes dhe jo **180** punonjes, nje numer ky me i ulet nga ai qe kerkohet ne piken 1. te kriterave te kapacitetit teknik te DT.

2. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur 1 Ing nivel master ose ekuivalent per Menaxhim Projektsh, 1 inxhinier mjedisi Profili Energjetike, 1 Inxhinier Ndertimi profil strukturist te kerkuar ne piken 4 te kriterit te kapacitetit teknik germa c, d dhe g.

3. Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion per 4 shofere, nga 5 te kerkuar ne piken 4.1.vi. te kriterave te vecanta te kapacitetit teknik.

4. Operatori ekonomik ka paraqitur ne total 3 kamiona nga 7 te kerkuar ne DT. Nuk ka paraqitur autovinc, pompe per thithje uji, sistemin wellpoint per heqje ujrash, aparature elektronike per kontrollin e presionit, pompe presioni per testime, autobetonieret 4 cope, autobot uji ka paraqitur vetem 1 nga 2 te kerkuar, te kerkuara ne piken 10 te kriterave te vecanta te kapacitetit teknik te DT.

5. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” parashikohet se: “ *Analizë teknike të koston për cdo zë punimi të paraqitur në preventiv, analiza e të cilës nuk figuron në manual.* ” Nga verifikimet e kryera rezulton se nuk është dorëzuar analizë koston për zërat të cilat nuk figurojnë në manual.

6. Nuk disponon staf të kualifikuar për:

- a) 60 punonjës të certifikuar me deshmi te sigurimit teknik 60 lëshuar nga IQT ose ekuivalente në përputhje me zërat e punimeve në preventiv.
- b) 2 Elektricitist vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- c) 2 Hidraulik vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- d) 3 Teknik ndërtimi vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- e) 8 Manovratorë të mjeteve të rënda, vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me

Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme.

- f) 5 Shoferë vërtetuar me kontratë pune dhe patentë përkatëse.
- g) 1 Punonjës të specializuar për dhënien e ndihmës së parë, me dëshmi të lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizma ndërkombëtar akreditues të njohur nga RSH.
- h) 4 Specialistë për montim/salidim tubash HDPE shoqëruar me certifikatat/dëshmitë përkatëse
- i) 1 Specialist për testimin e tubove nën presion HDPE

7. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” parashikohet se: “ Për paisjet: Tuba, rakorderi, matësa uji , operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim prodhuesi /distributori të autorizuar. Në rast se autorizimi është dorëzuar nga distributor i autorizuar duhet të shoqërohet me marrëveshjen e partneritetit Prodhuës-Distributor ku të pasqyrohen tagrat dhe kompetencat e distributorit. Autorizimi të jetë i dedikuar për këtë procedurë të përfshijë shitjen dhe shërbimet e lidhura me të, si edhe të përmbajë të gjithë të dhënat e kontaktit. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogët e produkteve të mësipërme të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike.” Nga verifikimi rezulton se nuk është dorëzuar as autorizim dhe as katalogë.

8. Nuk disponon kontratë me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve Shqiptare.

9 Nuk disponon kontratë qeraje/furnizimi për fabrike betoni dhe nyje inertesh si dhe autorizim prodhuesi për pajisjet: tuba, rakorderi, matësa uji të kërkuara në pikat 9 të DT.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, u konstatua se oferta e OE “**BE-IS**” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

4. S’kualifikimi BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k me NIPT K61625001I, “**Arkonstudio**” sh.p.k me NIPT L42019004I, me administrator Z.Nasjel Çiço dhe “**Viante Konstruksion**” sh.p.k me NIPT K47103804L, me administrator Z.Gjergji Bezati **për arsyet e mëposhtme**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

Në formularin e ofertes së dorëzuar nga BOE është ndryshuar një nga zerat e preventivit konkretisht: Nr.3.8.1.4.1 Valvula DN 50- DN 100 janë kërkuar nga AK 100 cope ndërsa BOE ka ndryshuar këtë ze të preventivit në 110 cope., duke ndryshuar strukturën e preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, ***pasi ka shtuar ose ulur sasi të zërave konkretë të tij, Neni 51 i ligjit të prokurimit publik, nuk e lejon autoritetin kontraktor të modifikojë ofertën, duke ndryshuar sasinë e zërave të punimeve në preventiv. Gjithashtu siç parashikohet në nenin 53, pika 1 të këtij ligji, nga ana e autoritetit kontraktor nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme***”.

Neni 66 pika 4 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ka të bëjë me gabimet aritmetike: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij ose nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe

shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gabim aritmetik por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të preventivit.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Ed Konstruksion” shpk & “Arkon Studio” shpk & “Viante” ka kontratë bashkëpunimi të lidhur para noterit publik nr.9126 rep dhe nr.2849 kol datë 16.12.2019 ku është parashikuar se:

“ArkonStudio” shpk do të kryejë 25 % të punimeve sipas aneksit I bashkëngjitur

“Viante” shpk do të kryejë 35 % të punimeve sipas aneksit I bashkëngjitur

“ED Konstruksion” shpk do të kryejë 40 % të cilat përfshijnë të gjitha punimet që ngelen në preventiv që do të kryhen nga “Arkonstudio” shpk dhe “Viante” shpk sipas aneksit I bashkëngjitur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se është dorëzuar vetëm një dokument (jo pjesë e kontratës noteriale) ku janë përcaktuar punimet e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ArkonStudio” shpk ndërkohë që nuk janë dorëzuar elementët konkretë të bashkëpunimit të punimeve që do të kryejë shoqëria “Viante” shpk. Për rrjedhojë nuk mund të vlerësohet mbi dokumentacionin e dorëzuar si nga anëtari “ED Konstruksion” shpk ashtu edhe nga anëtari “Viante” shpk i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

3. Referuar elementëve konkretë të bashkëpunimit të marrë përsipër nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “ArkonStudio” shpk rezulton se në total janë marrë përsipër punime në vlerën pa TVSH 50,112,908 lekë $50,112,908 / 145,021,471 = 34.55 \%$.

Pra referuar Formularit të Ofertës, rezulton që anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “ArkonStudio” shpk ka marrë përsipër referuar Preventivit **34.55%** e cila është më e madhe se **25 %** që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Kjo bie në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të VKM 914/2014 e cila parashikon se *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me procure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*

Sa më sipër anëtari i BOE ka marrë përsipër kryerjen e shërbimit në një vlerë më të vogël se angazhimi i marrë përsipër referuar kontratës së bashkëpunimit çka bie në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të VKM. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP edhe në Vendimet KPP 823/2016, KPP.

4. OE “Ed Konstruksion” shpk ka paraqitur autorizim distributori dt.16.12.2019 ne permbushje te pikes 10 te kriterave te vecanta te DT.

Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” parashikohet se: *“Për paisjet: Tuba, rakorderi, matësja uji , operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim prodhuesi /distributori të autorizuar. Në rast se autorizimi është dorëzuar nga distributor i autorizuar duhet të shoqerohet me marrëveshjen e partneritetit Prodhues-Distributor ku të pasqyrohen tagrat dhe kompetencat e distributorit. Autorizimi të jetë i dedikuar për këtë procedure të përfshijë shitjen dhe shërbimet e lidhura me të, si edhe të përmbajë të gjithë të dhënat e kontaktit. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogët e produkteve të mësipërme të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike.”*

Nga verifikimi rezulton se është dorëzuar Autorizim i Distributorit të Autorizuar lëshuar nga shoqëria “Al Nobel” shpk për shoqërinë “Ed Konstruksion” shpk ku pretendohet se shoqëria “Al Nobel” shpk shfaqet në cilësinë e distributorit të autorizuar të prodhuesit pa specifikuar emrat e prodhuesve.

Gjithashtu, në kundërshtim me Kriteret e vecanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“ Në rast se autorizimi është dorëzuar nga distributor i autorizuar duhet të shoqerohet me marrëveshjen e partneritetit Prodhues-Distributor ku të pasqyrohen tagrat dhe kompetencat e distributorit ”* nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion që të provojë lidhjen prodhues-distributor të autorizuar. Gjithashtu nuk është dorëzuar asnjë katalog për pajisjet e propozuara.

5. Referuar elementëve konkretë të bashkëpunimit rezulton se anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “ArkonStudio” shpk ka marrë përsipër ndër tjera edhe FURNIZIMI DHE VENDOSJA E TUBOVE DHE RAKORDERIVE TE RRJETIT TE UJESJELLESIT për të cilat nuk dëshmon se disponon autorizim prodhuesi ose të distributorit të autorizuar për rakordet dhe tuba në përputhje me kriteret e vecanta të kualifikimit dhe elementët konkretë të bashkëpunimit duke rënë ndesh me nenin 74 pika 3 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohet se: *“ 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje ”.*

6. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” parashikohet se: *“ Analizë teknike të kostos për çdo zë punimi të paraqitur në preventiv, analiza e të cilës nuk figuron në manual. ”* Nga verifikimet e kryera rezulton se nuk është dorëzuar analizë kostosh për zërat të cilat nuk figurojnë në manual.

7. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” parashikohet se: “

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për vertetimin e tyre të paraqitet deklarata sipas shtojcës nr.9 e shoqeruar me kontratën, situacionin përfundimtar, akt kolaudimin.

Punët e ngjashme të realizuara me subjekte private duhet të vertetohen nëpërmjet lejes së ndërtimit, situacionit përfundimtar, aktit të kolaudimit, lejes së përdorimit dhe faturës tatimore të deklarimit të objektit në organet tatimore.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ed Konstruksion” shk & “Arkon Studio” shpk & “Viante” është krijuar me anë të kontratës së bashkëpunimit të lidhur para noterit publik nr.9126 rep dhe nr.2849 kol datë 16.12.2019 ku është parashikuar se:

“ArkonStudio” shpk do të kryejë 25 % të punimeve sipas aneksit 1 bashkëngjitur

“Viante” shpk do të kryejë 35 % të punimeve sipas aneksit 1 bashkëngjitur

“ED Konstruksion” shpk do të kryejë 40 % të cilat përfshijnë të gjitha punimet që ngelen në preventiv që do të kryhen nga “Arkonstudio” shpk dhe “Viante” shpk sipas aneksit 1 bashkëngjitur.

Në nenin 74 pika 3 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohet se: *“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave,*

plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”

Anëtari i BOE “ED Konstruksion” shpk disponon përqindjen më të lartë, për rrjedhojë duhet të dëshmojë se disponon një objekt të vetëm në vlerë sa 50 e fondit limit ose 89,489,851.5 lekë pa TVSH.

Nga verifikimet e kryera rezultojnë se:

- i. Kontratë me objekt Ndërtim Rrjeti Ujesjelles në rrugën Naim Frashëri me vlerë punimesh me TVSH 24,385,567 dhe 20,321,305.83 lekë pa TVSH, H nuk plotëson kushtin e një objekti të vetëm sa 50 % e fondit limit.
- i. Kontratë me objekt "Ndërtim i shkolles 9- vjegare "Kosova Tirana".me vlerë punimesh me TVSH : 260,072,649.30 dhe 216,727,207 lekë pa TVSH, të kryera në masë 34.96 % nga shoqëria “Ed Konstruksion” shpk ose në vlerë **75,767,831.82**lekë pa TVSH nuk plotëson kushtin e një objekti të vetëm sa 50 % e fondit limit si edhe punimet e kontratës së mësipërme nuk janë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi.
- ii. Kontratë me objekt Ndërtim i salles se koncerte, prane Auditorit te Liceut Artistik'Jordan Misia' me vlerë 115,492,240 lekë me TVSH ose 96,243,533.33 lekë pa TVSH, të kryera në masë 9.9 % nga shoqëria “Ed Konstruksion” shpk ose në vlerë **9,624,353.3** lekë pa TVSH nuk plotëson kushtin e një objekti të vetëm sa 50 % e fondit limit si edhe punimet e kontratës së mësipërme nuk janë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi.
- iii. Kontratë me objekt Ndërtim Unaza e re e Tiranës me vlerë 1,048,817,925 lekë me TVSH ose 874,014,937.5 lekë pa TVSH, të kryera në masë 10 % nga shoqëria “Ed Konstruksion” shpk ose në vlerë **87,401,493.75** lekë pa TVSH nuk plotëson kushtin e një objekti të vetëm sa 50 % e fondit limit si edhe punimet e kontratës së mësipërme nuk janë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi.
- iv. Kontratë shtesë me objekt Ndërtim Unaza e re e Tiranës me vlerë 203,012,310.72 lekë me TVSH ose 169,176,925 lekë pa TVSH, të kryera në masë 10 % nga shoqëria “Ed Konstruksion” shpk ose në vlerë **16,917,692.56** lekë pa TVSH nuk plotëson kushtin e një objekti të vetëm sa 50 % e fondit limit si edhe punimet e kontratës së mësipërme nuk janë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi.
- v. Kontratë me objekt Rikonceptim i Qendres Sarande me vlerë 85,431,953 lekë me TVSH ose 71,193,294.16lekë pa TVSH, të kryera në masë 33.4 % nga shoqëria “Ed Konstruksion” shpk ose në vlerë **23,778,560.25** lekë pa TVSH nuk plotëson kushtin e një objekti të vetëm sa 50 % e fondit limit si edhe punimet e kontratës së mësipërme nuk janë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi
- vi. Kontratë me objekt Unaza e Pogonit me vlerë 137,897,895 lekë me TVSH ose 114,914,912.5 lekë pa TVSH, të kryera në masë 24 % nga shoqëria “Ed Konstruksion” shpk ose në vlerë **27,579,579** lekë pa TVSH nuk plotëson kushtin e një objekti të vetëm sa 50 % e fondit limit si edhe punimet e kontratës së mësipërme nuk janë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi
- vii. Kontratë me objekt Rikualifikim i Shetitores Republika me vlerë 96,285,204 lekë me TVSH ose 80,237,670 lekë pa TVSH, të kryera në masë 31.4 % nga shoqëria “Ed Konstruksion” shpk ose në vlerë **25,194,628.38** lekë pa TVSH nuk plotëson kushtin e një objekti të vetëm sa 50 % e fondit limit si edhe punimet e kontratës së mësipërme nuk janë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi
- viii. Kontratë me objekt Rikonstruksion i Rruges Koli Marku nuk plotëson kushtin e një objekti të vetëm sa 50 % e fondit limit si edhe punimet e kontratës së mësipërme nuk janë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi si edhe kontrata e mësipërme nuk është shoqëruar me formularin e vlerësimit.
- ix. Nga verifikimet e kryera rezultojnë se anëtari i BOE “ED Konstruksion” shpk ka dorëzuar kontratën me emërtim Rikonstruksion i Liceut Jordan Misja, kontrata baë dhe shtesë Referuar

Formularit të Vlerësimit kontrata ka përfunduar në datën kanë përfunduar në 7.11.2016 , si edhe kontrata Rehabilitim I shetitores Miqesia Polican e cila ka përfunduar në datë 10.10.2016 kontrata të cilat janë jashtë afatit 3 vjecar të parashikuar në gërmën “a” të kriterit të mësipërm dhe në nënin 26 pika 6 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Për sa më sipër, për sa kohë që punimet e kontratës së mësipërme janë jashtë afatit 3 vjecar nuk merren në shqyrtim. Gjithashtu punimet e kontratës së mësipërme nuk janë të ngjashme me kontratën objekt prokurimi.

Gjithashtu, nuk përmbush as gërmën “b” pasi vlera monetare për punime të ngjashme referuar zërave të preventivit nuk është sa dyfishi i vlerës së fondit limit për të gjithë kontratat e marra së bashku.

8. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit “Kapaciteti Teknik” në piken 5 germa c) parashikohet se:

“Gjithashtu, te kete pjese te stafit teknik punonjës te certifikuar si

- **1 Ing nivel master ose ekuivalent për Menaxhim Projektesh**, i cili të figuroje në listepagesën e kompanisë dhe të paraqitet diploma, kontratë punes, cv dhe të figuroje në listepagesat e shoqërisë.

Nga verifikimi kryer rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk disponon një inxhinier për menaxhim projektesh.

9. Ka paraqitur kontrate me një laborator testim betoni por nuk ka paraqitur dokumentacionin që verteton se laboratori është i akredituar nga organizma kombetare ose nderkombetare sic *kerkohet në piken 10 të kriterëve të vecanta të DT.*

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e **BOE “Ed Konstruktion” sh.p.k**, **“Arkonstudio” sh.p.k** dhe **“Viante Konstruktion” sh.p.k** **nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.**

5.S’kualifikimi Operatori ekonomik “Ergi” sh.p.k me NIPT K02727229P me administrator Z.Ergi Balla , për arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se

- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1. OE “Ergi” shpk ka paraqitur listepagesat e punonjesve per muajt Janar 2019-Shtator 2019 dhe nuk ka paraqitur listepagesat per muajt Tetor 2018-Dhjetor 2018 te kerkuara ne piken 1 te kriterëve të vecanta të kualifikimit të DT. Mosdorezimi i listepagesave per keto muaj nuk verteton plotesimin e kriterit se ofertuesi ka te siguruar një mesatare prej 180 punonjesish per periudhen e kerkuar Tetor 2018-Shtator 2019.

2. Në përmbushje të kriterit 4 të kapacitetit teknik OE “Ergi” shpk ka paraqitur dokumentacion për ing.mjedisi E.B për të cilën nuk ka paraqitur diplome sic është kërkuar në DT, pika 4.

3. OE “Ergi” shpk nuk ka paraqitur inxhinier në nivel master ose ekuivalent për Menaxhim Projektesh i kërkuar në piken 5 germa c) të kriterëve të kapacitetit teknik.

4. OE “Ergi” shpk nuk ka paraqitur inxhinier elektrik (minimumi nivel bachelor) i kërkuar në piken 5

germa e) te kritereve te kapacitetit teknik.

5. Operatori ekonomik “Ergi” shpk nuk ka paraqitur 4 Specialistë për montim/saldim tubash HDPE shoqëruar me certifikatat/dëshmitë përkatëse dhe 1 Specialist për testimin e tubove nën presion HDPE te kerkuar ne DT ne piken 4.1 vii dhe viii.

6. OE “Ergi” shpk nuk ka paraqitur Licensen me Kodin III.2.A (1+2) dhe licensen me kodin III.2.B (1+2), te kerkuara ne piken 7 dhe 8 te kritereve te kapacitetit teknik ne DT.

